



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:124568
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05760909

PPP.nr.53/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, Y.Y., nga shati Kuk Komuna e Dragashit të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.Q., nga Prizreni, ndaj debitorit, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS) me seli në Prishtinë, Distrikti në Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.525/24 të datës 08.04.2024 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës dëgjimore, me datën 31.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS) me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit për përmbartim, P.nr.525/24 të datës 08.04.2024 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Enis Hoxha nga Prizreni, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Y.Y., nga shati Kuk Komuna e Dragashit të cilin me autorizim e përfaqëson av. M.Q., nga Prizreni, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.525/24 të datës 08.04.2024, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2570/2016 i datës 14.09.2021, i plotfuqishëm nga data 12.02.2024, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 15.03.2024, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike sh.a (KEDS) me seli në Prishtinë, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit, në emër të ardhurave personale për periudhën nga data 01.12.2016 deri me datën 21.05.2021 shumën neto në lartësi prej 20,618.20 euro, në emër të përvojës së punës shumën prej 167.70 euro, në emër të tatimit në pagë shumën prej 1.032,3 euro, në emër të kontributit pensional si kontribut nga punëdhënësi dhe punëmarrësi shumën prej 2.279.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% duke

filluar nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, gjegjësisht nga data 31.10.2016 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 898.80 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, në të kundërtën përmbarimi të realizohet me ndalimin e mjeteve dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe paluajtshme deri në përmbushjen e kërkesës së kreditorit.

Debitori në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin e përmbaruesit privat, ka theksuar se kreditori para se të paraqes propozim për përmbarim është dashur që të paraqes kërkesë për të shtjerrë mundësin brenda institucionit për pagesën e detyrimit sipas aktgjykimit C.nr.2570/2016 me qëllim që të ulen shpenzimet procedurale, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit të anulohet urdhri për përmbarim i përmbaruesit privat si dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përmbarimore në tërësi.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar i autorizuari i kreditorit, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit, ka kërkuar nga gjykata që prapësimi i të refuzohet në tërësi si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se, prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se, organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht aktgjykimin në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti në kuptim të nenit 22 paragrafit 1, pika 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përmbarimi, në këtë çështje përmbarimore, ndërsa sipas nenit 24 par.1 të LPP-së, thuhet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilën është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje është i përmbarueshëm po qe se ka marrë formën te prerë si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”,* po ashtu gjykata gjeti se aktvendimi në fjalë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1 të LPP-së, e sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pra ky dokument përmbarimor i përmban të gjitha të dhënat për tu përmbaruar në procedurën e përmbarimit, me këtë vendim gjyqësor është urdhëruar përmbushja e detyrimit në të holla, nga ana e debitorit, e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor i plotëson kushtet sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”,* andaj, aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.691/2023, i dt.22.09.2023, i

plotfuqishëm nga data 16.10.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 01.11.2023, dhe i njëjti aktvendim është në origjinal, dhe e përmban klauzolën e përmbarueshmërisë dhe të ekzekutueshmërisë, dhe se për këtë arsye, pala kreditore, ka bërë propozimin për përbarim të dhunshëm të këtij vendimi gjyqësor të përmbaruesi privat si organ i përbarimit, e sa i përket prapësimit si mjet i rregullt juridik në procedurën e përbarimit, të paraqitur kundër një vendimit të organit përmbarues, e në rastin konkret të Urdhrit të lartcekur për përbarim të përmbaruesit privat, bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së, ndërsa për shkaqet e parapara për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së, derisa shkaqet e thirrura në prapësimin e palës debitore, nuk përbën asnjërin nga shkaqet e parapara sipas këtij neni.

Gjykata rikujton se, në këtë procedurë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e rrethanave tjera, me përjashtim të vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi, si dhe përshtatshmërisë së tij, dhe pretendimet e dhëna të debitorit në prapësim, nuk janë pengesë për kryerjen e përbarimit, ngase në këtë procedurë vlen i ashtuquajtura parimi i legalitetit rigoroz formal si parim i veçantë i procedurës përbarimore, i cili ka të bëjë me rregullat e nxjerrjes së urdhrin mbi lejimin e ekzekutimit dhe sipas të cilit gjykata nuk ka tagër të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë materiale të vendimit apo të përmbajtjes së tij dhe të rregullsisë së dokumentit, por vetëm shqyrtohen elementet formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përbarimi si dhe përshtatshmërisë së vendimit që është objektë i përbarimit.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga të thënat e cekura me lartë, bazuar në nenin 3 dhe 73 par.3 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.53/2024

Datë 31.05.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.